

TIRANE 2019

**RREGULLORE E KOMISIONIT TË
PËRHERSHËM PËR DHËNIEN E
GRADËS SHKENCORE
"DOKTOR
E UNIVERSITETIT POLITEKNIK TË TIRANËS**




**UNIVERSITETI
POLITEKNIK
I TIRANES**

Sheshi "Nënë Tereza",4
Tiranë ALBANIA
Tel: +355 4 2227914
Web: upt.al

MIRATOHET

Kryetari i Senatit Akademik

Prof. Dr. Andrea MALIQARI



RREGULLORE E
KOMISIONIT TË
PËRHERSHËM PËR
DHËNIEN E GRADËS
SHKENCORE “DOKTOR”
E UNIVERSITETIT POLITEKNIK TË TIRANËS

Tiranë 2019

PËRMBAJTJA

1. Rregullorja e Komisionit të Përhershëm për dhënien e gradës shkencore “Doktor” në UPT mbështetet në kornizën ligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë dhe në statutin e Universitetit Politeknik të Tiranës (UPT).
2. Komisioni i përhershëm për dhënien e gradës shkencore “Doktor” në UPT mban emërtimin Këshilli i Profesorëve.
3. Këshilli i Profesorëve pranë njësive kryesore të UPT-së, ngrihet në zbatim të kornizës ligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë dhe Statutit të Universitetit Politeknik të Tiranës.
4. Numri i anëtarëve të Këshillit të Profesorëve në UPT është pesë ose shtatë. Anëtarët e Këshillit të Profesorëve janë personel akademik me kohë të plotë, i kategorisë “Profesor”.
5. Këshilli i Profesorëve në mbledhjen e parë, pas konstituimit të tij, zgjedh me votim të fshehtë Kryetarin e Këshillit të Profesorëve. Zgjedhja bëhet me shumicën e thjeshtë të votave të të gjithë anëtarëve të tij 50% + 1. Mandati i Kryetarit të Këshillit të Profesorëve është 2 vjeçar. Kandidati për kryetar vetëkandidohet ose propozohet nga një ose më shumë anëtarë të KP.
6. Mbledhjet e KP thirren dhe drejtohen nga kryetari. Thirrja e mbledhjes së KP mund të bëhet edhe me kërkesë të një të tretës (1/3) së anëtarëve të tij. Mbledhja e KP realizohet atëherë kur janë të pranishëm 2/3 e anëtarëve të tij (jo më pak se 4 anëtarë kur numri i plotë i anëtarëve të tij është 5 dhe jo më pak se 5 kur numri i anëtarëve është 7). Vendimet merren me shumicë të thjeshtë të anëtarëve të pranishëm në mbledhje me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë rregullore. Votimet në KP bëhen të fshehta.
7. Këshilli i Profesorëve miraton fushat e studimeve të doktoratës të njësive bazë mbi bazën e propozimeve të tyre dhe ia përcjell ato për informim Senatit, kur ndryshimi i fushave nuk është më i madh se 20% në raport me ato ekzistuese për një periudhë tre vjeçare.
8. Kur fushat e studimeve të doktoratës ndryshohen për më shumë se 20% të atyre ekzistuese, atëherë ato miratohen paraprakisht prej Këshillit të Profesorëve dhe më pas i përcillen Senatit të UPT-së për vijimin e miratimit të tyre përfundimtar në përputhje me kornizën ligjore në fuqi dhe në respekt të institucionit dhe të rregullores së përcjelljes së shkresave brenda njësisë kryesore dhe UPT-së. Vendimi për miratimin e fushave të studimeve të doktoratës merret me shumicë të cilësuar të të gjithë anëtarëve të KP (katër nga pesë anëtarë ose pesë nga shtatë anëtarë të Këshillit të Profesorëve, respektivisht përbërjes me pesë ose shtatë anëtarë). Në rast se nuk arrihet shumica e cilësuar, kryhet një votim i dytë. Në rast se edhe gjatë votimit të dytë do të përsëritet e njëjta situatë, vendimi shtyhet për t'u marrë në mbledhjen tjetër, në të cilën një shumicë e thjeshtë e të gjithë anëtarëve do të ishte e mjaftueshme.

9. Miratimi i fushave të studimeve të doktoratës bëhet me shumicë të cilësuar: katër nga pesë anëtarë ose pesë nga shtatë anëtarë të Këshillit të Profesorëve, respektivisht përbërjes me pesë ose shtatë anëtarë.
10. Këshilli i Profesorëve shqyrton dosjen e çdo kandidati që i paraqet njësisia bazë pranë së cilës ai do të kryejë studimet e doktoratës . Ai cakton të paktën një relator për shqyrtimin e dosjes dhe mbështetur në raportin e lëshuar si dhe në gjykimin e anëtarëve të tij, miraton ose jo propozimin e njësisë bazë për kandidatin dhe mentorin e tij.
11. Këshilli i Profesorëve monitoron gjithë procesin e fitimit të gradës shkencore “Doktor” të kandidatëve të njësisë kryesore, pranë së cilës ai funksionon.
12. Këshilli i Profesorëve miraton përbërjen e jurisë së mbrojtjes së doktoratës mbi propozimin e njësisë bazë dhe ia përcjell atë drejtuesit të njësisë kryesore të UPT-së në respekt të institucionit dhe të rregullores së përcjelljes së shkresave brenda njësisë kryesore dhe UPT-së.
13. Këshilli i Profesorëve pas mbrojtjes së doktoratës dhe vlerësimit të jurisë merr vendimin për dhënien ose jo të gradës shkencore “Doktor” me votim të hapur dhe të argumentuar me një shumicë të cilësuar të të gjithë anëtarëve të tij (katër nga pesë anëtarë ose 5 nga shtatë anëtarë të tij). Këshilli i Profesorëve i përcjell drejtuesit të njësisë kryesore vendimin e tij për vijimin e mëtejshëm të procedurave, në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.
14. Këshilli i Profesorëve mund të bëjë propozime konkrete për ndryshimin e rregullores së funksionimit të tij dhe ia përcjell Senatit të UPT-së (neni 16 i statutit) për miratimin e tyre përfundimtar.
15. Këshilli i Profesorëve mund të bëjë propozime për ndryshimin e statutit të UPT-së dhe rregullores së tij, për çështjet që kanë të bëjnë me studimet e doktoratës.
16. Këshilli i Profesorëve merr vendime dhe i bën ato publike në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.
17. Këshilli i Profesorëve trajton ankimimet që bëhen nga aplikantët dhe studentët e doktoratës në lidhje me procedurat e ndjekura dhe vendimmarrjet përkatëse. Në çdo rast, ankimuesit i kthehet përgjigje zyrtare në përputhje me procedurat administrative.
18. Kryetari i Këshillit të Profesorëve kryen këto detyra:
 - a. drejton mbledhjet e Këshillit të Profesorëve ;
 - b. organizon punën e Këshillit për ndjekjen dhe monitorimin në vazhdimësi të procesit të doktoratave ;
 - c. organizon punën për trajtimin dhe zgjidhjen e ankesave në lidhje me procesin e doktoratave ;
 - d. informon në mënyrë periodike drejtuesit e njësisive bazë dhe të njësisë kryesore për problematikat që janë konstatuar ;
 - e. përcjell vendimet e Këshillit të Profesorëve me firmën e tij në respekt të institucionit dhe të rregullores së përcjelljes së shkresave brenda njësisë kryesore dhe UPT-së.

19. Këshilli i Profesorëve ka një sekretar/sekretare, që propozohet dhe miratohet që në mbledhjen e tij të parë, pas konstituimit.
20. Sekretari/sekretarja e Këshillit të Profesorëve ka këto detyra:
 - a. mirëadministron dokumentacionin e këshillit të profesorëve;
 - b. mban procesverbalin e mbledhjeve dhe zbardh vendimet e Këshillit të Profesorëve;
 - c. kryen çdo detyrë tjetër që i ngarkon Këshilli i Profesorëve brenda fushës së aktivitetit të tij.
21. Mënyra dhe masa e shpërblimit të Këshillit të Profesorëve dhe sekretarit/sekretares së tij, miratohet nga Bordi i Administrimit, me propozimin e Senatit Akademik të UPT-së.
22. Mbi këtë rregullore bazë, Këshillat e Profesorëve të njësive kryesore, mbështetur në specifikat e tyre, mund të hartojnë kërkesa shtesë, të cilat miratohen nga asambleja e personelit të njësisë.
23. Rregullorja e Këshillit të Profesorëve hyn në fuqi në datë 25.06.2019.

Miratuar me vendim të Senatit Akademik Nr. 13, datë 25.06.2019